

“Paguaj me kartë Credins Visa”

1. Fushata

Fushata promociionale “Paguaj me kartë Credins Visa dhe përfito 10% cashback” (në vijim “Fushata”), organizohet nga Banka Credins sh.a., në bashkëpunim me subjekte në fushën e bar restoranteve, të pajisura me terminale POS Credins, që operojnë në zonën e bregdetit të jugut, më synim promovimin e pagesave me karta Credins.

Fushata zhvillohet në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë Rregullore.

2. Përkufizimet

“Llogaria” do të thotë llogaria e lidhur me Kartën Visa, e hapur në Bankën Credins në emër të një individi mbi moshën 18 vjeç.

“Kartë” do të thotë kartë e vlefshme Visa Individ e lëshuar nga Banka Credins

“Mbajtës i kartës” do të thotë një individ që është përdorues i një Karte

“Transaksion blerjeje me kartë” blerje në terminale Pos të tregtarëve të përfshirë në fushatë

“Cashback” shuma e kredituar nga Banka Credins në llogarinë e lidhur me kartën.

3. Kohëzgjatja e Fushatës

Fushata do të jetë e vlefshme nga data 07 Gusht 2026 deri më 07 Shtator 2026.

Banka Credins rezervon të drejtën të mbyllë, ndryshojë apo ndërpresë Fushatën edhe përpara këtij afati, për arsye operationale, tregtare ose në rast të ezaurimit të fondit promociional, pa qenë e detyruar të japë kompensime shtesë ndaj pjesëmarrësve.

Çdo ndryshim lidhur me Fushatën do të publikohet në kanalet zyrtare të komunikimit të Bankës Credins.

4. Kartat pjesëmarrëse në Fushatë

Pjesë e Fushatës janë vetëm kartat Visa segmenti Individ, lëshuar nga Credins Bank:

- ✓ Visa Debit
- ✓ Visa Classic
- ✓ Visa Prepaid

5. Përfituesit e Fushatës

Në fushatë përfshihen klientët individë Kartëmbajtës Visa të Bankës Credins të cilët:

- ✓ Kryejnë transaksionë blerje me kartat Visa të përfshira në fushatë brenda periudhës së përcaktuar të kohëzgjatjes së fushatës
- ✓ Transaksionet e blerjeve me kartat pjesë e fushatës kryhen në терминалет POS Credins të tregtarëve të përfshirë në fushatë

6. Terminalet POS të tregtarëve të lokalizuar në bregdet të përfshirë në fushatë:

- ✓ Folie Marine & Soleil – Jal
- ✓ Moyo & Pepperon - Drymades
- ✓ Havana & Rose - Dhërmi
- ✓ Nassau - Dhërmi

7. Përfitimet e Fushatës

Klientët që plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë Rregullore do të përfitojnë:

- ✓ 10% cashback për çdo transaksion blerje me kartat pjesë e fushatës në терминаlet e tregtarëve të përfshirë të fushatës – maksimumi 4'000 Lek gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së Fushatës.
- ✓ Cashback do të kreditohet vetëm një herë për çdo klient/kartë gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së Fushatës.

8. Kushtet e Përfitimit të Cashback

Përfitimi i cashback realizohet vetëm në rast se:

- ✓ karta është aktive dhe në status normal përdorimi;
- ✓ klienti ka kryer të paktën një transaksion blerjeje të suksesshëm me kartë brenda kohëzgjatjes së fushatës
- ✓ transaksionet janë kontabilizuar dhe regjistruar me sukses në sistemet e Bankës.
- ✓ Maksimumi i përfitimit të vlerës cashback është 4'000 Lek për kartë/klient

Për efekt të kësaj Fushate, konsiderohen të vlefshme vetëm transaksionet e blerjes me kartë në терминаlet POS të Credins Bank të përcaktuara të tregtarëve pjesë e fushatës brenda kohëzgjatjes së fushatës.

9. Kreditimi i Cashback

Cashback do të kreditohet në kartën ose llogarinë e lidhur me kartën përkatëse të klientit individ kartëmbajtës brenda datës 10 shtator 2026.

Kreditimi i cashback do të realizohet vetëm pasi transaksioni të jetë përpunuar dhe kontabilizuar me sukses në sistemet e Bankës.

10. Të Drejtat e Bankës

Banka Credins rezervon të drejtën:

- ✓ të verifikojë vlefshmërinë e transaksioneve dhe përmbushjen e kushteve të Fushatës;
- ✓ të përjashtojë nga përfitimi klientët në rast evidentimi të elementëve të mashtrimit, abuzimit ose përdorimit jo të rregullt të kartës;
- ✓ të refuzojë përfitimin e cashback në rast të mosplotësimit të kushteve të kësaj Rregulloreje;
- ✓ të ndryshojë termat dhe kushtet e kësaj Rregulloreje, duke publikuar versionin e përditësuar në faqen zyrtare të bankës.

11. Publikimi i Rregullores

Kjo Rregullore publikohet në faqen zyrtare të [Bankës Credins](#) dhe hyn në fuqi nga data 07 Gusht 2026.